



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministry of Environment and Spatial Planning
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja

RAPORT I VLERËSIMIT EX-POST

PËR

LIGJIN NR. 08/L-250 PËR NDRYSHIME KLIMATIKE

Raporti për Vlerësimin Ex - Post të Ligjit Nr. 08/L-250 për Ndryshime Klimatike i miratuar me Vendimi e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.14 dt.19.03.2026.

Institucioni propozues	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Titulli i Raportit të Vlerësimit Ex-Post	Raport i Vlerësimit Ex-Post për Ligjin Nr. 08/L-250 për Ndryshime Klimatike ¹
Personi kontaktues	Shëndrita Latifi, Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit dhe Mbështetjes Ligjore të Departamentit Ligjor
Grupi punues	<u>Anëtarët e Grupit Punues:</u> 1. Shëndrita Latifi, DL/MMPH, Kryesuese; 2. Abdullah Pirçe, DMM/MMPH, zv. Kryesues; 3. Visare Hoxha, DMM/MMPH, anëtare; 4. Dorant Haxhidauti, DMM/MMPH, anëtar; 5. Lindita Morina, DMM/MMPH, anëtare; 6. Ardian Reçica, DL/MMPH, anëtar; 7. Bashkim Kastrati, AMMK, MMPH, anëtar; 8. Sylejman Latifi, ARPL/MMPH, anëtar; 9. Mentor Shala, IHMK/MMPH, anëtar; 10. Elbasan Shala, Inspektorati i MMPH-së, anëtar; 11. Miradije Asllanaj, DIEKP/MMPH, anëtare; 12. Xhavit Bulliqi, ZL/ZKM, anëtar; 13. Fellanza Mekuli, MFPT, anëtare; 14. Merlinda Ramaj, DL/MINT, anëtare; 15. Lulëzim Korenica, ME, anëtar; 16. Nysrete Doda, MBPZHR, anëtar; 17. Arbnore Jaha, MAPL, anëtare; 18. Lendita Mehmeti – MSH/ IKSHP, anëtar/e
Data:	03 Maj 2025

¹ Raporti për Vlerësimin Ex - Post të Ligjit Nr. 08/L-250 për Ndryshime Klimatike i miratuar me Vendimi e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.14 dt.19.03.2026.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ndryshimet klimatike janë një nga sfidat më të mëdha me të cilat po përballen vendet në botë, përfshirë edhe Kosovën. Kosova, si shumë shtete të tjera, është e ndikuar nga ndryshimet klimatike dhe, për pasojë, ka marrë masa për të adresuar këtë çështje përmes ligjeve dhe politikave të ndryshme. Kosova, si një vend i vogël dhe i kufizuar në burime natyrore, është e ndjeshme ndaj pasojave të ndryshimeve klimatike. Ndryshimet në normalen e klimës mund të kenë ndikime të mëdha, si: rritja e temperaturave, përmbytjet dhe thatësira, ulja e biodiversitetit, si dhe ndikimi në shëndetin publik.

Si përgjigje për këto sfida, në Kosovë kemi ligje të miratuara për tu mbrojtur apo përballur me ndryshimet klimatike. Ligji Nr. 08/L-250 për Ndryshime Klimatike i miratuar me 5 janar 2024 ka për qëllim përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësisë të autoriteteve shtetërore lidhur me marrjen e masave që synojnë zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike, koordinimin dhe monitorimin e rezultateve të tyre, si dhe përmbushjen e detyrimeve sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të detyrueshme për Kosovën.²

Mbrojtja nga ndryshimet klimatike ka një rëndësi të jashtëzakonshme për sigurinë e planetit dhe për mirëqenien e njerëzve. Ndryshimet klimatike po shkaktojnë pasoja të rënda dhe të shpejta, që ndikojnë jo vetëm në mjedisin natyror, por edhe në shoqëri, ekonomi dhe shëndetësi.

Ky raport bën vlerësimin Ex-post të Ligjit Nr. 08/L-250 për Ndryshime Klimatike (në tekstin e mëtejshëm, “Ligji”), pjesë e kornizës ligjore që rregullon sektorin e ndryshimeve klimatike në nivel qendror dhe lokal.

Në këtë drejtim, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka themeluar Grupin Punues³ i cili është mandatuar që të bëjë vlerësimin Ex-Post të Ligjit. Grupi punues udhëhiqet nga Departamenti Ligjor dhe Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit, pjesë e të cilit janë edhe përfaqësuesit e departamenteve dhe institucioneve tjera.

Në këtë vlerësim, është zgjedhur metoda “Vlerësimi i zbatimit dhe pajtueshmërisë” si një nga tri (3) llojet e vlerësimit Ex-Post, me qëllim që të vlerësohet në pika kyçe procesi i zbatimit të Ligjit. Për më tepër ky vlerësim do të evidentojë nëse zbatimi po realizohet në mënyrën e duhur, si dhe me qëllim të identifikimit të faktorëve që kanë ndihmuar ose penguar zbatimin adekuat të tij.

Në fund, Raporti rekomandon veprime të cilat çojnë në funksion të zbatimit të plotë të Ligjit. Më konkretisht, rekomandimet konsistojnë në hapat që duhet ndërmarrë për të adresuar sfidat e identifikuara në zbatimin e plotë të tij.

² Ligji Nr. 08/L-250 për Ndryshime Klimatike i miratuar me 5 janar 2024

³ Vendimi me Nr. Prot 1961/25, datë 02.04.2025 për Themelimin e Grupit Punues për Hartimin e Raportit të Vlerësimit Ex-Post për Ligjin Nr. 08/ L-250 për Ndryshime Klimatike

I. HYRJE

A) Konteksti i vlerësimit

Gjatë procesit të monitorimit dhe analizës së zhvilluar gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, por edhe nga të dhënat e mëhershme vërehet se zbatimi i ligjit nga institucionet përgjegjëse është tejte sfidues, kryesisht për shkak të disa mangësive që janë vërejtur në ligj.

Përzgjedhja e këtij ligji për t'iu bërë vlerësimin Ex-Post është bërë, ndër të tjerash, duke marrë parasysh rëndësinë e tij në tërë ciklin e ndryshimeve klimatike në vend.

Prandaj, nisur nga kjo si dhe bazuar në kërkesat e dala nga Departamentet në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe institucionet e tjera publike, MMPH është përcaktuar në vlerësimin Ex-Post të Ligjit Nr. 08/L-250 për Ndryshime Klimatike.

B) Qëllimi dhe fushëveprimi i vlerësimit

Qëllimi i këtij Raporti të Vlerësimit Ex-Post është të nxjerrë në pah sfidat kryesore në fushën e mjedisit të përcaktuara me Ligjin përkatës. Përveç zbatimit, fokus i dytë i vlerësimit është pajtueshmëria e Ligjit me legjislacionin tjetër në fuqi. Pra lloji i vlerësimit është “Vlerësimi i zbatimit dhe pajtueshmërisë”.

Rrjedhimisht, vlerësimi Ex-Post i Ligjit është konsideruar një instrument shumë i rëndësishëm dhe efektiv për të identifikuar nivelin e zbatimit, sfidat që hasim gjatë zbatimit, si dhe masat që duhet ndërmarrë me qëllim të fuqizimit të zbatimit të këtij Ligji.

Vlerësimi i Ligjit Nr. 08/L-250 për Ndryshime Klimatike bëhet për periudhën nga hyrja në fuqi në janar të vitit 2024 deri në muajin Dhjetor 2025. Ky vlerësim *Ex-post* në fushëveprim ka disa pika të Ligjit.

Palët e përfshira në mënyrë aktive në procesin e zbatimit të Ligjit janë:

- Zyra e Kryeministrit;
- Ministritë.

II. PËRSHKRIMI I LIGJIT QË DO TË VLERËSOHET DHE METODOLOGJIA E ZBATUAR

A) Përshkrimi i Ligjit ose Aktit nënligjor që do të vlerësohet

Ligji ka për qëllim përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësive të autoriteteve shtetërore lidhur me marrjen e masave që synojnë zbutjen e efekteve të ndryshme klimatike,

koordinimin dhe monitorimin e rezultateve të tyre, si dhe përmbushjen e detyrimeve sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të detyrueshme për Kosovën.

Vlerësimi Ex-post është realizuar në disa pika të Ligjit duke përfshirë analizimin dhe gjetjen e një mangësie ku nuk përfshihet sistemi i Monitorimit, Raportimit, Verifikimit dhe Akreditimit (MRVA). Ky sistem është tanimë obligim i Republikës së Kosovës ndaj Agjendës së Reformave për Planin e Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor. Gjithashtu, në vlerësim është gjetur duplikim i strategjive dhe masave, si me Strategjinë Afatgjate të Dekarbonizimit, Planin për Energji dhe Klimë dhe Kontributin e Përcaktuar Kombëtar Vullnetar. Disa gabime tjera minore në nene të caktuara do adresohen gjithashtu.

B) Zingjiri i rezultateve

Zingjiri i rezultateve për llojin e vlerësimit të përcaktuar nga grupi punues “Vlerësimi i zbatimit dhe pajtueshmërisë” paraqitet në tabelën si në vijim:

Niveli i rezultatit	Treguesi
Ndikimi (impakti)	Vlerësim pozitiv rreth zbatimit të ligjit si rezultat i vlerësimeve ex-post të tij
Rezultati (outcome)	Zbatim i kënaqshëm i ligjit dhe i njëjti të jetë në harmoni me ligjet relevante
Outputi	Arritja e rezultateve të cilat ndikojnë pozitivisht në mjedis

Arritja e outputit varet prej një numri të inputeve, si: hartimi dhe miratimi i ndryshimeve të cilat duhet të jenë të përshtatshme me ligjet dhe me Direktivat e Bashkimit Europian. Po ashtu, input tjetër për të arritur këtë output është rekrutimi i stafit të nevojshëm dhe ekspert të fushës të cilët janë të specializuar në fushat e kërkuara dhe aspekte specifike të ligjit.

Arritja e rezultatit (outcome) varet nga arritja e outputit, pra: kur njësitë janë të themeluara, kanë staf të mjaftueshëm dhe janë trajnuar, atëherë edhe zbatimi i ligjit duhet të jetë i nivelit të mirë. Arritja e rezultatit (outcome) varet edhe nga një proces tjetër, plotësim-ndryshimi i Ligjit për Ndryshimet Klimatike.

Arritja e ndikimit (impaktit) është niveli i rezultatit më të lartë dhe nuk lidhet vetëm me Ligjin për Ndryshimet Klimatike. Arritja e ndikimit varet nga vlerësimet jashtë administratës publike, për nivelin e zbatimit të ligjit të cilit i është bërë vlerësimi ex-post. Arritja e impaktit (ndikimit) do të vlerësohet nga të dhënat nga organizata jashtë Qeverisë që bëjnë monitorimin e zbatimit të ligjeve.

C) Metoda e vlerësimit *Ex-post*

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si ministri përgjegjëse duke u bazuar në Udhërrëfyesin për Vlerësimin Ex-post të Legjislacionit në Republikën e Kosovës,

ka themeluar grupin punues me datë 02.04.2025. Grupi punues është mandatuar për të bërë vlerësimin Ex-post të Ligjit Nr. 08/L-250 për Ndryshime Klimatike. Grupi punues udhëhiqet nga Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me Departamentin për Mbrojtjen e Mjedisit, si dhe pjesëmarrës të institucioneve të tjera kompetente në fushën e ndikimit në ndryshimet klimatike të cilët janë të involvuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi në zbatimin e Ligjit siç janë Zyra e Kryeministrit, Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rajonal.

Metodologjia në përgatitjen e Raportit të vlerësimit *Ex-Post* të Ligjit përfshinë përdorimin e metodës së mbledhjes së të dhënave në bazë të Raportit përmbledhës dhe studimeve që janë bërë nga Grupi Punues për Analizën e ndikimit të CBAM në industri dhe ekonomi të Kosovës, të mbështetur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Ligji është analizuar përmes metodës së hulumtimit të këtyre të dhënave dhe praktikave të shteteve anëtare të Bashkimit Europian.

Mbajtja e takimeve me akterët relevant.

Në kuadër të procesit të vlerësimit janë zhvilluar edhe takime konsultative me akterë relevantë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Përveç institucioneve publike, Zv. Kryesuesi i Grupit Punues ka realizuar takime edhe me ekspertë të angazhuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), me zyrtarë nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, si dhe me përfaqësues të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Këto konsultime kanë ndihmuar në identifikimin më të saktë të sfidave ekzistuese dhe në formulimin e rekomandimeve të bazuara në praktika të mira ndërkombëtare.

III. REZULTATET E VLERËSIMIT

A) Zbatueshmëria e Ligjit

a. Informacione të përgjithshme

Nga procesi i vlerësimit Ex-post, konkretisht nga takimet e realizuara të Grupit Punues me institucionet kompetente, rezulton se Ligji nuk është zbatuar dhe nuk i ka dhënë rezultatet e synuara andaj Grupi Punues nuk ka vazhduar me Vlerësimet e Përformancës ose të Ndikimit dhe ka konstatuar se zbatimi i Ligjit është përcjellë me disa sfida, si:

- *Mungesa e përfshirjes së MRVA-së:* MRVA është një mjet kontrolli për ndotësit individual dhe i njëjti hap rrugën për ndëshkim, tregtim të karbonit apo edhe

përfshirje ndaj një politike protektive që Bashkimi Europian ka ndaj tregjeve tona, e cila njihet si "Carbon Border Adjustment Mechanism". Mungesa e bazës ligjore për funksionalizimin e sistemit të Monitorimit, Raportimit, Verifikimit dhe Akreditimit (MRVA), është si rrjedhojë e faktit që Ligji është aprovuar para ratifikimit të "Projektligjit nr. 10/L-002 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi aranzhimet për zbatimin e përkrahjes së Unionit për Kosovën në kuadër të instrumentit për reforma dhe rritje" (më tutje Plani i Rritjes). Në Planin e Rritjes dhe agjendën e reformave, rajoni dhe Kosova kushtëzohen në funksionalizimin e MRVA-së deri më Qershor 2026.

- ***Mungesa e përcaktimit të detyrave të reja të Agjencisë e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës (AMMK):*** për zbatimin e plotë të këtij ligji dhe për funksionimin e sistemit të sipërpërmendur duhet të themelohet një sektor në AMMK që do të jetë më efektiv për përdorimin e këtij sistemi.
- ***Mungesa e trajnimeve specifike për ngritje të kapaciteteve në zbatim më të mirë të Ligjit*** - edhe pse numër i vogël i stafit, institucionet publike në nivel qendror dhe lokal kanë vlerësuar si sfidë apo arsye mungesën e trajnimeve specifike për zbatimin e plotë të Ligjit.
- ***Rishqyrtimi i dispozitave ligjore rreth Strategjisë Afatgjatë për Dekarbonizim*** - duke marrë parasysh nevojën për një qasje më fleksibile dhe horizontale, është vërejtur se kjo strategji ka karakter detyrues ligjor, e që duhet të jetë një dokument udhëzues strategjik. Në këtë drejtim, duhet të analizohet mundësia e heqjes së referencave të detyrueshme ndaj saj nga ligji ose modifikimi i nenit ekzistues, duke saktësuar se Strategjia për Dekarbonizim ka rol orientues për zhvillimin e politikave klimatike dhe energjetike dhe harmonizohet me Planin Kombëtar për Energji dhe Klimë (NECP) dhe Kontributet Kombëtare të Përcaktuara (NDC). Gjatë zbatimit të ligjit në vitin e parë të hyrjes në fuqi, Sekretariati i Këshillit për Ndryshime Klimatike ka vënë në pah efikasitetin e politikave klimatike dhe ka propozuar reformimin e prioritetëve ndaj agjendës politike për ndryshime klimatike.
- ***Përcaktimi i saktë i fushëveprimit të Këshillit dhe Sekretariatit për Ndryshime Klimatike*** - për zbatimin e plotë të këtij ligji dhe për funksionimin Këshillit dhe Sekretariatit për ndryshime klimatike është e nevojshme përcaktimi i saktë i fushëveprimit dhe kompetencave me qëllim për të bërë punën e strukturave më efikase, bazuar në eksperiencën e pjesëtarëve të Sekretariatit në efikasitetin e tyre.
- ***Mungesa e akteve nënligjore dhe ndikimi në zbatim*** - përkundër faktit se Ligji përcakton nxjerrjen e akteve nënligjore për çështje thelbësore, asnjë akt nënligjor nuk është miratuar që nga viti 2024, kjo ka bërë që shumë funksione të mbesin të pazbatueshme.

B) Pajtueshmëria

Grupi punues ka vlerësuar se ka disa duplikime në tekstin e Ligjit si dhe mungesë të normave tjera të rëndësishme në vetë Ligjin por nuk ka vërejtur nëse ka ndonjë mos pajtueshmëri me Ligjet tjera.

IV. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

– PËRFUNDIME

Analiza Ex-post e Ligjit ka identifikuar përfundimet si në vijim:

- Mungesa e përfshirjes së dispozitave ligjore për themelimin e sistemit të MRVA;
- Mungesa e përfshirjes së dispozitave ligjore për formimit të një sektori i cili do të menaxhonte dhe monitoronte sistemin e MRVA-së
- Ndryshimi dhe plotësimi i dispozitave ligjore aktuale në Ligj rreth funksionimit dhe përgjegjësisë të organeve kryesore të menaxhimit të kësaj fushe si të Këshillit dhe Sekretariatit për Ndryshime Klimatike.
- Ndryshimi dhe plotësimi i dispozitave ligjore aktuale rreth dokumenteve strategjike të parapara në Ligj me qëllim të përshtatjes konkrete të zbatimit dhe monitorimit të ndryshimeve klimatike në sistemin e vendit tonë.
- Mungesën e ekspertizës dhe kapaciteteve profesionale në këtë fushë të re në Kosovë por edhe në të gjithë globin e cila tashme ka marr një interesim të madh për shkak të nevojës së mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit.
- Mungesa e nxjerrjes së akteve nënligjore të cilat kanë ndikuar në mos zbatimin e funksioneve të parapara në këtë Ligj.

REKOMANDIME

Rekomandimet në vijim janë rezultat i vlerësimit të grupit punues të cilat natyrshëm lidhen me përfundimet si më lartë:

- Krijimi i sistemit për MRVA në nivel instalimi përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit duke u bazuar në praktikat dhe metodologjitë përkatëse evropiane, të përshtatura me rrethanat e Republikës së Kosovës si dhe duke ofruar mundësinë e modifikimit të sistemit të MRVA-së në përputhje me prioritetet e politikave shtetërore për klimën dhe energjinë;
- Përcaktimi i AMMK-së si autoriteti kompetent përgjegjës për zbatimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e sistemit MRVA; Ndryshimi dhe plotësimi i dispozitës ligjore rreth Strategjisë Afatgjatë për Dekarbonizim ku rekomandohet

që kjo strategji të mos ketë karakter detyrues ligjor, por të mbetet një dokument udhëzues strategjik duke marrë parasysh nevojën për një qasje më fleksibile dhe horizontale dhe të ketë rol orientues për zhvillimin e politikave klimatike dhe energjetike. Gjithashtu të harmonizohet me Planin Kombëtar për Energji dhe Klimë (NECP) dhe Kontributet Kombëtare të Përcaktuara (NDC);

- Ndryshimi dhe plotësimi i dispozitave ligjore rreth fushëveprimit të Këshillit dhe Sekretariatit për Ndryshime Klimatike, duke e bërë punën e strukturave më efikase, bazuar në eksperiencën e pjesëtarëve të Sekretariatit në efikasitetin e tyre;
- Rishqyrtimi i nevojave për rritjen e kapaciteteve profesionale përmes vlerësimit të nevojave për trajnimin e zyrtareve kompetent në këtë fushë në të gjithë zingjirin politikë bërës, zbatues dhe monitorues për module të nevojshme të fushës së ndryshimeve klimatike si dhe shqyrtimi i mundësisë të rekrutimit të pozitive të reja shtesë në njësitë përkatëse.
- Nxjerrja e të gjitha akteve nënligjore të parashikuara në Ligji.

SHTOJCAT TEKNIKE

Shtojca 1: Pyetësi

Vlerësim Ex-post i Ligjit NR. 08/L-250 për Ndryshime Klimatike

Lloji i vlerësimit:

Zbatimi dhe Pajtueshmëria

Pyetjet me qëllim vlerësimin e zbatimit dhe pajtueshmërisë:

Pyetje të përgjithshme:

1. A janë nxjerrë të gjitha aktet nënligjore që derivojnë nga Ligji?

Jo të gjitha por deri më tani janë nxjerrë disa dokumente të rëndësishme, është aprovuar NDC-ja vullnetare dhe është përpiluar drafti final i Planit për Energji dhe Klimë, si dhe dy Udhëzime Administrative që lidhen me emetimet e gazeve serrë (GHG). Megjithatë, mungon ende akti nënligjor që vendos bazën funksionale të sistemit MRVA, i cili konsiderohet komponent thelbësor për zbatimin e plotë të ligjit.

2. A është ndarë buxheti i planifikuar për zbatimin e aktit juridik?

Jo. Ministria nuk ka pasur nevojë për ndarje të posaçme buxhetore për aktivitetet e deritanishme, pasi përpilimi i NDC-së dhe dy udhëzimeve administrative është realizuar pa kosto shtesë për institucionin dhe me mbështetje nga donator si UNDP dhe Banka Botërore.

3. Sa i avancuar është zbatimi i aktit juridik?

Zbatimi është në fazë të mesme. Disa veprime janë ndërmarrë duke funksionalizuar Këshillin dhe Sekretariatit për Ndryshime Klimatike. NDC-ja vullnetare është aprovuar dhe është draftuar Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë.

4. Cilat janë vështirësitë në zbatimin e aktit juridik?

Vështirësitë përfshijnë: mungesën e një baze të qartë ligjore për MRVA; deri më tani ka qenë vështirë përmbushja e stafit në Ministri por një gjë e tillë vetëm se ka ndodh me dy zyrtar tanimë në divizionin e ri për ndryshime klimatike.

Efikasiteti:

1. A ka kushtuar procesi i zbatimit të aktit juridik?

Jo. Deri më tani, aktivitetet e realizuara, përfshirë përpilimin e NDC-së dhe dy UA-ve të ndërlidhura me GHG, janë zhvilluar pa kosto për Ministrinë, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.

2. A ka hapësirë për ta thjeshtuar zbatimin dhe për t'i kursyer resurset (paratë, personeli, ...)

Po. Me përfshirjen e sistemit MRVA përmes një kornize të qartë nënligjore dhe funksionalizimin e kapaciteteve brenda AMMK, zbatimi do të bëhet më i strukturuar dhe më efikas, duke shmangur mbivendosje dhe kursyer resurset institucionale.